




Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec

Opština Orahovac / Municipality Rahovec



**RAPORT PËRMBLEDHËS PËR ORGANIZIMIN E KONSULTIMEVE
PUBLIKE PËR PLANIFIKIMIN, PËRPILIMIN DHE MIRATIMIN E
PROJEKT-BUXHETIT PËR VITIN 2026**

Shtator 2025

Raport përmbledhës për konsultime publike – Tabela e përmbajtjes

1.1 ECURIA E PROCESIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PLANIFIKIMIN DHE PËRPILIMIN E PROPOZIM-BUXHETIT KOMUNAL.....	4
2. PËRMBLEDHJE TABELARE E KONSULTIMEVE TË MBAJTURA PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2026-2028 DHE PROPOZIM-BUXHETIN VJETOR PËR VITIN 2026	6
3. METODOLOGJIA DHE KRITERET PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT TË KËRKESAVE	8
4. TABELARI I DETAJUAR SIPAS KATEGORIVE TË KËRKESAVE DHE STATUSIT QË MARRIN	10
4.1 KËRKESAT SI REZULTAT I DËGJIMEVE BUXHETORE TË MBAJTURA PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB 2026-2028).....	10
4.2 KËRKESAT SI REZULTAT I DËGJIMEVE BUXHETORE TË MBAJTURA PËR PROJEKT-PROPOZIM BUXHETIN PËR VITIN 2026	18
4.3 KËRKESAT PËR KATEGORINË E INVESTIMEVE KAPITALE TË PRANUARA PËRMES E-MAILIT	55
4.4 KËRKESAT/PRIORITETET E PRANUARA NGA BUXHETIMI ME PJESËMARRJE	57
5. KONKLUZIONET DHE HAPAT E MËTEJSHËM.....	58

1. HYRJE

Përmes këtij Raporti përmbledhës të Konsultimeve Publike synohet që të dokumentohen të gjitha format e konsultimit publik që I kanë paraprirë përpilimit/draftimit të projekt-propozimit të buxhetit nga ana e ekzekutivit të komunës. Kjo nënkupton që përfshihen takimet publike obligative të mbajtura në gjashtëmujorin e parë nga ana e Kryetarit, format të konsultimit publik në të shkruar, dëgjimet buxhetore për KAB e po ashtu ato për buxhet vjetor, etj.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna 04/2023, përcaktohen rregullat që sigurojnë përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve përfaqësuese në vendimmarrje lokale, transparencën dhe llogaridhënien e organeve të komunës, gjithashtu përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave dhe akteve nënligjore në komunë si dhe obligimet e komunave për të siguruar qasjen nëpërmjet teleprezencës dhe teknologjisë digjitale për të garantuar transmetimin në distancë dhe monitorimin nga autoritetet qendrore, shoqëria civile dhe qytetarët. Sipas këtij Udhëzimi, Komuna duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimmarrje duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e: 1.1 Takimeve publike; 1.2 Konsultim publik për projekt aktet normative dhe dokumente të politikave; 1.3 Takime konsultative me qytetarë; 1.4 Dëgjime buxhetore.

Me qëllim të dokumentimit të mbajtjes së takimeve, konsultimeve publike, dëgjimeve buxhetore dhe takimeve tjera, komuna siguron ftesat, materialet, sigurimin e kushteve, mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e raportit nga takimet dhe aktivitetet e përfshirjes së qytetarëve në diskutime dhe konsultime publike, gjatë hartimit të akteve dhe dokumenteve lokale. Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt- propozimit gjatë mbajtjes së konsultimit publik mbledh komentet dhe përgatit raport për rezultatet e konsultimit publik.

Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, respektivisht Nenit 60, përcaktohet se përgatitja dhe rishqyrtimi i propozim-buxheteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore bëhet nga Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe Kryetari i Komunës, ku ZKF duhet, me ose para 1 Korrikut të vitit aktual kalendarik, t'i dërgojë kryesuesit të secilit departament komunal të komunës një qarkore buxhetore komunale e cila përmban informata dhe udhëzime mbi

- (i) tavanet e shpenzimeve të aplikueshme për departamentin përkatës për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësime mbi këto tavane për dy (2) vitet e ardhshme fiskale, dhe
- (ii) metodologjinë dhe formularët që duhet të shfrytëzohen nga departamenti përkatës gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal. Kjo qarkore buxhetore duhet të përfshijë: a) procedurat që duhet përdorur nga departamenti gjatë përgatitjes së propozim buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore; b) të dhënat të cilat duhet të parashtrihen në propozim-buxhet dhe në kërkesën për ndarje buxhetore; c) detale mbi formatin në të

cilin duhet të përgatitet propozim-buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore; dhe d) afatin e fundit deri në të cilin departamenti duhet të përfundojë dhe t'i dorëzojë ZKF-së propozimbuxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore.

Pas miratimit të propozim-Buxhetit Komunal nga Kryetari i Komunës, Kryetari i Komunës, deri me 1 Shtator të vitit përkatës fiskal, duhet t'ia dorëzojë këto dokumente Kuvendit Komunal. Propozim-Buxheti Komunal duhet të përfshijë:

- a) parashikime dhe supozime ekonomike dhe buxhetore;
- b) vlerësime të përgjithshme të të ardhurave nga të gjitha burimet, duke përfshirë (i) grantet, në përputhje me shumat e këshilluara në qarkoren(t) buxhetore të nxjerra nga Ministri, (ii) ndihmën nga burimet jashtë Kosovës, dhe (iii) të ardhurat e parashikuara vetanake të komunës;
- c) një cak të përgjithshëm të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimit;
- d) vlerësime të përkrahjes së pritur nga donatorët; dhe
- e) çfarëdo të dhëna të tjera me rëndësi materiale për buxhetin të cilat ZKF e konsideron të arsyeshme për t'u përfshirë.

1.1 ECURIA E PROCESIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PLANIFIKIMIN DHE PËRPILIMIN E PROPOZIM-BUXHETIT KOMUNAL

Bazuar në ligjin për Qeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017 si dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë (MAPL) Nr. 04/2023 të Hapur në Komuna, komuna e Rahovecit ka organizuar dëgjimet buxhetore. Me datë 13.2.2025 Kryetari i Komunës Smajl Latifi me vendim ka caktuar grupin punues i cili sipas UA Nr. 04/2023 ka organizuar dëgjimet dhe ka adresuar kërkesat e pranuar nga qytetarët në dëgjimet buxhetore <https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/VENDIM-5297-Per-caktimin-e-grupit-punues-per-hartimin-e-projekt-buxhetit-te-Komunes-per-vitin-2026-2028.pdf>.

Raporti përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor dhe është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare. Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë. Të gjithë emrat dhe fotografitë e qytetarëve që janë përdorur gjatë hartimit të këtij raporti janë marrë me pëlqimin e tyre. Grupi punues ka vendosur që të redaktoj dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky raport në ditën e miratimit është bërë publik dhe i është dorëzuar Kryetarit të komunës dhe Asamblesë së Komunës së Rahovecit. Në faqen e komunës në kuadër të këtij procesi janë publikuar, kalendari i dëgjimeve, plani i punës, ftesat për pjesëmarrje, raportet e shkurta nga

dëgjimet, procesverbalet nga dëgjimet dhe materialet e tjera provuese të cilat janë të listuar në fund të këtij dokumenti si aneks.

Grupi punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027, në këtë përbërje:

- 1.1. Ekrem Bytyqi – kryesues;
- 1.2. Skender Hamza – anëtar;
- 1.3. Ardian Rama – anëtar;
- 1.4. Egzon Thaqi – anëtar;
- 1.5. Izet Morina – anëtar;
- 1.6. Alban Gashi - anëtar;
- 1.7. Blerta Gashi – anëtar;
- 1.8. Albion Krasniqi – anëtar;
- 1.9. Qendresa Kryeziu – anëtare;
- 1.10. Dafina Gashi – anëtare;
- 1.11. Kaltrina Duraku = anëtare;
- 1.12. Ardit Halilaj – anëtar;
- 1.13. Almedina Jaha = anëtare;
- 1.14. Agnesa Ramadani – anëtare.

Bazuar në vendimin e kryetarit, grupi punues ka mbajtur disa takime radhazi, duke bërë Planin e veprimit për dëgjimet buxhetore, përpilimin e kalendarit të dëgjimeve buxhetore dhe njoftimeve për publikim. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë procesin e dëgjimeve buxhetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2026-2028, të bëjë hartimin e Planit të brendshëm komunal për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, të bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, të caktojë personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike dhe të bëjë hartimin e tij në afatin ligjor që parashihet në Udhëzimin Administrativ (Mapl) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna, të bëjë hartimin e raportit nga dëgjimi buxhetor dhe ta përgatisë për ta dërguar në Kuvendin Komunal.

Sipas planit të punës, për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve komuna ka organizuar 6 dëgjime buxhetore, në të cilat kanë marrë pjesë 275 qytetarë prej të cilëve 136 burra dhe 139 gra. Ndërkohë, për projekt-buxhetin e vitit 2026, komuna ka organizuar 16 dëgjime buxhetore në të cilat kanë marrë pjesë 266 qytetarë prej të cilëve 159 burra dhe 107 gra.

Publikimet për këto dëgjime buxhetore janë të qasshme në linkun në vijim:
<https://rahovec.rks-gov.net/degjime-buxhetore/?tax=>

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike, si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo të refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Projekt - buxheti i vitit 2026, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, është finalizuar dhe është proceduar, në Kuvendin e Komunës së Rahovecit.

2. PËRMBLEDHJE TABELARE E KONSULTIMEVE TË MBAJtura PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2026-2028 DHE PROPOZIM-BUXHETIN VJETOR PËR VITIN 2026

Grupi i interesit / Me kë është mbajtur dëgjimi	Lokacioni	Data	Nr. total i pjesëmarrësve	Gra	Burra	Nr. total i kërkesave të parashtruara
Dëgjimet buxhetore për KAB 2026-2028						
Drejtorët shkollave, koordinatorët e cilësisë, psikolog, dhe pedagog	Salla e Kuvendit Komunal	22.5.2025; Ora 10:00	52	16	36	3
Punëtorët Shëndetësor	Salla e Kuvendit Komunal	22.5.2025; Ora 13:45	49	26	23	2
Kryetaret e Fshatrave dhe Lagjeve Urbane	Salla e Kuvendit Komunal	23.5.2025; Ora 10:00	22	1	21	10
OJQ, Biznese, Fermere, dhe Grupe te Interesit	Salla e Kuvendit Komunal	21.05.2025; Ora 13:45	38	8	30	1
Me rininë, gratë, pensionistët dhe komunitetet pakicë	Salla e Kuvendit Komunal	21.05.2025;	56	36	20	4
Buxhetimi Pergjegjshm Gjinator	Salla e Kuvendit Komunal	03.06.2025; Ora 10:00	58	52	6	5
TOTAL			275	139	136	25
Dëgjimet buxhetore për propozim-buxhetin për vitin 2026						
Grupi i interesit / Me kë është mbajtur dëgjimi	Lokacioni	Data	Nr. total i pjesëmarrësve	Gra	Burra	Nr. total i kërkesave të parashtruara
Gratë në biznese	Restaurant "Ana kafe" – Krushë e Madhe	21.7.2025	17	16	1	3
Gratë në biznese	Kooperativa "Krusha"	21.7.2025	22	22	0	
Bizneset	Kompania "Eurofood" Xërxë	21.7.2025	29	29	0	6
Banorët e fshatrave Ratkoc, Malësi e Vogël, Dejnë, Vrajak,	Ratkoc qendra e fshatit	22.7.2025	60	2	58	8

Bratotin dhe banorëve të tjerë						
Banorët e fshatrave Xërxë dhe Dejnë	Amfiteatri në Kompleksin e Gradishit	23.7.2025	19	1	18	5
Banorët fshatrave Fortesë, Sapniq, Pataqan i Poshtëm dhe rrethinë	Objekti i shkollës në Fortesë	23.7.2025	10	0	10	9
Banorët fshatrave Opterushë, Zoqisht, Retijë dhe Retijë e Ulët.	Objekti i shkollës në Opterushë	24.7.2025	12	1	11	14
Banorët e fshatit Hoçë e Madhe	Objekti i Shtëpisë Kulturës	Nuk është mbajtur dëgjimi buxhetor për shkak të mos pjesëmarrjes së qytetarëve.				
Banorët e fshatrave Drenoc, Senoc, Pastasellë, Zatriq, Kaznik, Pataqan i Epërm.	Objekti i shkollës fillore në Drenoc	25.7.2025	11	0	11	30
Buxhetimi gjinor në komunën e Rahovecit	Kafiteria "Bon Bon"	28.7.2025	14	14	0	3
Banorët e fshatrave Çifllak, Polluzhë, Dobidol, Kramovik, Gur i Kuq, Mrasor.	Objekti i shkollës fillore në Çifllak	28.7.2025	15	0	15	38
Fshatrat Krushë e Madhe, Nagac, Hoçë e Vogël, Brestoc, Celinë.	Amfiteatri i muzeut "Ukshin Hoti"	29.7.2025	15	2	13	15

Punonjësit e shërbimeve publike dhe punëtorët shëndetësorë	QKMF "Fahredin Hoti" në Rahovec	1.8.2025	26	13	13	
Qumështarët	Objekti i grumbullimit të qumështit në Ratkoc	1.8.2025	22	0	22	4
Përfaqësuesit e OJQ-ve, bizneseve, fermerëve, rinisë, përfaqësues të shkollave dhe grupet e interesit	Salla e Kuvendit	4.8.2025	30	7	23	7
Banorët e lagjeve të qytetit (I, II, III, IV)	Rahovec	4.8.2025	9	0	9	4
TOTAL			266	107	159	
Buxheti me pjesëmarrje						
Takimi i parë	Parku i qytetit	14.08.2025	31	7	24	5
Takimi i dytë	Parku i qytetit	21.08.2025	60	8	52	1

3. METODOLOGJIA DHE KRITERET PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT TË KËRKESAVE

Sipas Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna 04/2023, të gjitha propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet që janë paraqitur nga publiku brenda mënyrës dhe afatit kohor të përcaktuar me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Shqyrtimi i komenteve bëhet nga grupi punues i projekt propozimit i cili vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara. Në këtë kapitull janë të paraqitura aspektet/kriteret si dhe terminologjia që grupi punues ka marrë për bazë për klasifikimin e statusit të kërkesave. Më poshtë janë të elaboruara detajisht këto aspekte dhe kriteret.

Sipas standardeve të UA nr 04/2023 grupi punues me shumicë votash ka vendosur sipas arsyetimeve që janë në këtë raport. Mbi kriteret e paracaktuara grupi punues ka vendosur të pranoj, refuzoj apo adresoj kërkesat që janë pranuar nga qytetarët gjatë dëgjimeve buxhetore. Sipas kriterëve të paracaktuara kërkesat janë trajtuar si vijon

Pranuar/Aprovuar: nënkupton që kërkesa konkrete e qytetarit konsiderohet se është e nevojshme për tu realizuar dhe si e tillë do të jetë pjesë e buxhetit për vitin 2026. Pra kërkesat e tilla, si për projekte kapitale, subvencione apo mallra & shërbime janë në buxhetin që i shkon kuvendit/asamblesë për miratim deri me 1 shtator.

Pjesërisht e pranuar/aprovuar: Nënkupton klasifikimin e kërkesave apo propozimeve të qytetarëve të cilat mund të përfshijnë disa lloj intervenimesh (psh. Në shtrimin e një rruge mund të kërkohej që përveç asfaltimit të rrugës, të punohet edhe në ndriqimin publik të asaj rruge apo edhe mbjelljen e drunjëve dekorativ/gjelbrimin përreth saj). Në këto raste, nëse komuna mund të ketë mundësi buxhetore apo thjesht të prioritetizoj vetëm një segment të kesaj kërkesë (shembull shtrimin e rrugës) atëherë arsyetohet që për këto arsye, kërkesa aprovohet për shtrimin e rrugës, mirepo për vitin 2026 nuk do të ketë mundësi intervenimi në ndriqim publik apo mbjelljen e drunjëve dekorativ. Si e tillë kërkesa mbetet pjesërisht e pranuar/aprovuar.

Adresuar: nënkupton që kërkesa e qytetarit adresohet te subjekti, palët, institucioni relevant. Kjo vlen dhe është relevante në rastet kur kërkesat apo propozimet e qytetarëve nuk janë në kompetencën komunale dhe janë përgjegjësi/kompetencë e një insitucioni tjetër (si psh KEK-ut, Ujësjiellësit, etj) dhe kur klasifikohet si e “Adresuar” nënkupton që Komuna do të adresoj apo ka adresuar kërkesën tek institucioni relevant. Adresuar po ashtu mund të nënkuptojë që një kërkesë e qytetarit vetëm se gjenë adresim në projektet ekzistuese komunale (të cilat mund të kenë filluar në vitet paraprake apo janë të planifikuara për vitet pasuese për të cilin po mbahet konsultimi) – që nënkupton se nëse grupi punues nuk është i qartë nëse kjo kërkesë do të jetë me saktësi shembull pjesë e projekteve të vitit 2026, do ta adresoj atë për shqyrtim/përfshirje në buxhet për vitet e ardhshme (term tjetër në këto raste përdoret “E konsideruar” apo “E marrë në konsideratë”).

E refuzuar: Nënkupton kërkesat e qytetarëve të cilat nuk përfshihen në buxhetin e komunës për vitin 2026. Kjo mund të jetë për shumë arsye e që mund të përfshijnë: mungesën e mjeteve financiare, fakti që kërkesa nuk bënë pjesë në prioritetet komunale, fakti që kërkesa është më shumë e natyrës individuale se sa me ndikim në komunitet, fakti që për realizimin e kërkesës/investimit do të duhet fillimisht të mënjanohen probleme të ndryshme si shpronësimet apo fakti që menaxhimi i pronës nuk është në kompetencë komunale, etj.

4. TABELARI I DETAJUAR SIPAS KATEGORIVE TË KËRKESAVE DHE STATUSIT QË MARRIN

Tabelari në vijim paraqet listimin e kërkesave të pranuar, duke i kategorizuar ato në bazë të natyrës që kanë, nëpër kategoritë si në vijim:

- Kërkesat e qytetarëve të natyrës “projekte kapitale”,
- Kërkesat e qytetarëve të natyrës “subvencione”,
- Kërkesat e qytetarëve të natyrës “mallra&sherbime”,
- Kërkesat për informacion apo pyetje të ndryshme rreth progresit në realizimin e “x” investimit, apo dhënies së “x” subvencionit, e kështu me radhë.

Legjenda e sqarimit të elementeve që gjenden në tabelarin më poshtë:

- Kategorizimi/Emertimi lartë me Capital Letters se a janë kërkesat në vazhdim të natyrës “INVESTIME KAPITALE”, “SUBVENCIONE”, “MALLRA & SHËRBIME”, apo “PYETJE/KËRKESË PËR INFORMACION/SUGJERIME”
- Kolona e parë tregon për “Kërkesat, sugjerimet, idetë, pyetjet e parashtruara në konsultim” dhe tregon në mënyrë sa më të detajuar se çfarë përfshinë kërkesa
- Kolona e dytë përfshinë “Emër mbiemër të personit apo organizatës që ka dhënë propozimin/kërkesën”
- Kolona e tretë përfshinë “Statusin e kërkesës se a është Pranuar/Aprovuar, Adresuar, Pjesërisht aprovuar, Refuzuar” – sipas kriterëve dhe metodologjisë së përcaktuar më lartë në kapitullin e mëhershëm
- Kolona e fundit përmban “Përgjigjet dhe arsyeshmërinë e komunës/grupit punues rreth kërkesës/propozimit të qytetarit apo organizatës që ka parashtruar atë, që tregon se cila janë arsyet e klasifikimit të kërkesës/propozimit në Statusin që është përcaktuar. Këtu duhet të jepen arsye dhe përgjigje sa më të detajuara dhe konkrete në mënyrë që qytetari apo organizata ta ketë të qartë se pse një kërkesë e tyre ka marrë statusin e tillë.

4.1 KËRKESAT SI REZULTAT I DËGJIMEVE BUXHETORE TË MBAJTURA PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB 2026-2028)

INVESTIME KAPITALE			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/orga nizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Ndriçim publik në Krushë të Madhe	Bashkim Ramadani, përfaqësues i komunitetit	Aprovohet	Grupi punues ka vlerësuar se zgjerimi dhe përmirësimi i ndriçimit publik në Krushë të Madhe është një nevojë e domosdoshme për rritjen e sigurisë së qytetarëve, lehtësimin e qarkullimit gjatë orëve të mbrëmjes dhe krijimin e një ambienti më të sigurt dhe funksional për komunitetin. Ky

			investim konsiderohet prioritar dhe është i realizueshëm brenda kapaciteteve buxhetore të planifikuara për vitin fiskal, prandaj projekti është aprovuar për implementim.
Terrene dhe pajisje sportive	Rron Iska, nxënës në SHML “Xhelal Hajda – Toni”	Aprovohet pjesërisht	Pas shqyrtimit të kërkesës, grupi punues ka vlerësuar se nevoja për përmirësimin e infrastrukturës sportive është e rëndësishme për zhvillimin rekreativ dhe fizik të komunitetit. Megjithatë, për shkak të kufizimeve buxhetore dhe prioriteteve të tjera kapitale të planifikuara për këtë periudhë, është e mundur të mbështetet vetëm një pjesë e projektit. Për këtë arsye, është aprovuar implementimi i fazës së parë, që përfshin ndërhyrjet bazike dhe një pjesë të pajisjeve sportive. Fazat e tjera do të shqyrtohen sipas mundësive buxhetore në periudhat e ardhshme.
Renovimi i shkollës fillore Sopniqi pas vërshimeve të fundit ku është dëmtuar kati i parë i objektit shkollor	Masar Gashi, drejtor në SHFMU “Sopniqi”	Pjesërisht	Grupi punues ka shqyrtuar me prioritet dëmet e shkaktuara nga vërshimet dhe ka konstatuar se ndërhyrjet emergjente në katin e parë të shkollës janë të domosdoshme për rikthimin e funksionalitetit dhe sigurisë së objektit. Megjithatë, për shkak të kufizimeve të buxhetit aktual dhe nevojës për shpërndarje të balancuar të fondeve në projekte të tjera emergjente, është e mundur të mbështetet vetëm një pjesë e renovimit në këtë fazë. Pjesa e mbetur do të shqyrtohet në rishikimet e ardhshme buxhetore ose përmes mundësive shtesë të financimit.

Krijojimi i një alternative buxhetore për shpronësimet ku komuna nuk ka pronë publike. Për moment i kemi dy raste specifike. Kërkoj që të ndahet një buxhet për shpronësimin e pronave private. Lagjja te rruga "Vëllezërit Frashëri" dhe lagjja e epërme që të kenë parcela për vendosjen e trafos, sepse departamenti i vlerësimit po i bën qytetarët të pakënaqur me vlerën që po ju jep parcelave të tyre. Meqenëse jemi në qarkoren e parë buxhetore, po e bëj këtë propozim.	Defrim Kafexhiu	Aprovohet	Grupi punues ka vlerësuar se situata aktuale e shpronësimeve në zonat e lartpërmendura paraqet sfida serioze në proceset e planifikimit dhe zhvillimit të infrastrukturës energjetike. Mungesa e pronave publike i detyron qytetarët të hyjnë në procedura jo të favorshme të vlerësimit të pronës, duke krijuar pakënaqësi dhe vonesa në realizimin e projekteve të nevojshme. Duke qenë se kjo është qarkorja e parë buxhetore, është e arsyeshme dhe e domosdoshme që të krijohet një linjë e dedikuar buxhetore për shpronësime, e cila do të mundësojë: • Procedura më transparente dhe më të drejta për qytetarët, • Sigurimin e lokacioneve të përshtatshme për vendosjen e trafove, • Përsheptimin e realizimit të projekteve të domosdoshme infrastrukturore. Për këto arsye, propozimi është aprovuar, dhe do të planifikohet një fond specifik brenda kapaciteteve buxhetore të vitit në vijim.
Rruga e dëmtuar në fshat, mungesë kanalizimi, mungesë trotuarësh, hapësirat publike të lirohen si dhe shqetësime	Selajdin Gashi, kryetar i këshillit të fshatit Çifllak	Aprovohet	Grupi punues ka konstatuar se gjendja infrastrukturore në këtë zonë kërkon ndërhyrje të menjëhershme për të siguruar

rreth numrit të madh të gjarpërinjëve.			sigurinë dhe mirëqenien e banorëve. Rruga e dëmtuar, mungesa e kanalizimit dhe trotuareve përbëjnë rrezik për qarkullimin dhe jetën e përditshme të komunitetit. Po ashtu, lirimi i hapësirave publike është i domosdoshëm për funksionalitetin e fshatit dhe respektimin e rendit publik. Në lidhje me shqetësimet për numrin e madh të gjarpërinjëve, do të ndërmerren masa në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse për pastrim, mirëmbajtje dhe sistemim të hapësirave që mund të pengojnë shfaqjen e këtij fenomeni. Duke marrë parasysh rëndësinë e çështjeve të ngritura dhe impaktin e drejtpërdrejtë në sigurinë e banorëve, projektet janë aprovuar për t'u përfshirë në planifikimin buxhetor të periudhës së ardhshme.
Kanalizimi në fshat nga fabrika e qumështit, shtrimi i disa rrugëve me kubëza	Murat Morina, kryetar i këshillit të fshatit Malësi e Vogël	Aprovohet pjesërisht	as vlerësimit të kërkesës, grupi punues ka konstatuar se ndërtimi i kanalizimit nga fabrika e qumështit paraqet një nevojë prioritare për komunitetin, duke pasur parasysh ndikimin e drejtpërdrejtë në higjienën publike dhe mbrojtjen e mjedisit. Për këtë arsye, kjo pjesë e projektit do të përfshihet në planifikimin buxhetor.

			Ndërsa sa i përket shtrimit të disa rrugëve me kubëza, për shkak të kufizimeve aktuale buxhetore dhe projekteve të tjera prioritare infrastrukturore, është e mundur të realizohet vetëm një pjesë e segmentëve të propozuar. Pjesa tjetër do të shqyrtohet në fazat e ardhshme të planifikimit, varësisht mundësive financiare. Për këto arsye, kërkesa aprovohet pjesërisht.
Riparimi i shkollës, kërkesë për pastrim të gropes septike, si dhe mirëmbajtja e rrugës dhe hapësirave publike deri në fshatin Piranë, rivendosja e dy pengesave afër shkollës	Mirsad Qehaja, kryetar i këshillit të fshatit Retijë e Poshtme	Refuzohet	Pas shqyrtimit të kërkesës, grupi punues ka vlerësuar se ndërhyrjet e propozuara, ndonëse të rëndësishme për komunitetin lokal, nuk mund të përfshihen në këtë fazë të planifikimit buxhetor për shkak të kufizimeve financiare dhe prioriteteve të tjera emergjente dhe kapitale të parapara për periudhën aktuale. Disa nga çështjet e ngritura, veçanërisht ato që lidhen me mirëmbajtje të rregullt, do t'i adresohen drejtorive përgjegjëse operative jashtë kornizës së investimeve kapitale, në varësi të kapaciteteve dhe planifikimit vjetor të mirëmbajtjes. Për këto arsye, kërkesa refuzohet në kuadër të buxhetit zhvillimor të kësaj faze.

SUBVENCIONE			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/orga nizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Financimi i studentëve jashtë vendit	Azize Kadiri, mësimdhënëse në SHFMU "Sadedin Hajda"	Aprovohet	Grupi punues ka vlerësuar se mbështetja e studentëve që ndjekin studimet jashtë vendit kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin arsimor, profesional dhe shoqëror të komunës. Investimi në rininë akademike përbën një kthim të rëndësishëm afatgjatë, duke mundësuar që të rinjtë të fitojnë njohuri dhe përvoja ndërkombëtare të cilat më pas mund t'i kontribuojnë komunitetit lokal. Për këtë arsye, dhe brenda kapaciteteve të planifikimit buxhetor, është aprovuar krijimi i një linje të dedikuar për mbështetjen e studentëve jashtë vendit.
MALLRA & SHËRBIME			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/orga nizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Mungesë pajisje në laboratorin e shkollës, veçmas për mungesë të kukullës për praktikë	Zana Ukshini, nxënëse në SHMLP "Selajdin Mullabazi – Mici"	Aprovohet	Grupi punues ka vlerësuar se pajisja e laboratorit me mjete të domosdoshme praktike është thelbësore për zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe përmbushjen e standardeve arsimore. Mungesa e një kukulle për praktikë paraqet pengesë të drejtpërdrejtë në realizimin e mësimdhënies praktike,

			sidomos në lëndët që kërkojnë demonstrime dhe ushtrime të simuluar. Duke qenë se investimi është i domosdoshëm, me kosto të arsyeshme dhe me ndikim të menjëhershëm në cilësinë e procesit mësimor, kërkesa aprovon dhe do të përfshihet në buxhetin për furnizime arsimore të vitit në vijim.
Infrastruktura e shkollës	Leonita Çuni, nxënëse në SHML "Xhelal Hajda – Toni"	Aprovohet	Grupi punues ka vlerësuar se objekti shkollor "Xhelal Hajda – Toni" ka nevojë për ndërhyrje infrastrukturore për të siguruar kushte më të mira mësimi, rritjen e sigurisë dhe funksionalitetit të hapësirave. Investimi në infrastrukturën shkollore konsiderohet prioritar, pasi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e arsimit dhe mirëqenien e nxënësve dhe stafit edukativ. Për këtë arsye, projekti aprovon dhe do të përfshihet në planifikimin buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas prioritetëve dhe mundësive financiare të komunës.
PYETJE/KËRKESË PËR INFORMACION/SUGJERIME			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/orga nizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Pyetje për dëmtimet në infrastrukturë sidomos në dritare dhe në dyer të shkollës, si dhe kur mund të ndërhyhet për tu rregulluar?	Vjollca Vuqitërna, drejtoreshë në SHML "Selajdin Mullabazi – Mici"	Aprovohet pjesërisht	Pas shqyrtimit të gjendjes së paraqitur, grupi punues vlerëson se riparimi i dritareve dhe dyerve të dëmtuara është i domosdoshëm për garantimin e sigurisë dhe kushteve bazë në shkollë. Megjithatë, për

			shkak të kufizimeve aktuale buxhetore dhe prioriteteve të tjera infrastrukturore të parapara për këtë periudhë, është e mundur të realizohet vetëm një pjesë e ndërhyrjeve të nevojshme. Ndërhyrjet urgjente, që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë dhe funksionalitetin minimal të objektit, do të përfshihen në programin e mirëmbajtjes, ndërsa pjesa e mbetur do të shqyrtohet për t'u përfshirë në fazat e ardhshme buxhetore.
Pyetje rreth ligjit se si është i përcaktuar me ligj dalja në pension para kohë e punëtorëve të arsimit?	Naim Kafexhiu, drejtor në SHFMU "Sadedin Hajda"	Aprovohet	Jane ligjet qe e percktojne
Pyetje rreth KRU Gjakova?	Beq Shala, kryetar i këshillit të fshatit Ratkoc		Adresohet te KRU
Planifikimi i buxhetit për 10 specialist për nga 150 euro në mujë? A keni planifikuar që të mbulohen këto shpenzime?	Fehmi Cena-Doktor specialist	Aprovohet	Aprovohet ne vazhdimesi
Pyetje rreth pagave jubilarë?	Belkize Kafexhiu, Kryetare e sindikatës në QKMF	Aprovohet	Vazhdohet varesisht sipas mundesive buxhetore ndarja e pagave jubilarë
Pyetje për ligjin e pagave, konkretisht për koeficientët?	Zymryte Nurkasa, zyrtare në administratë	Aprovohet	Ne janar vazhdon rritja e premtuar si dhe ndryshimi i koeficienteve sipas rregullores se re
Pyetje rreth bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet komunale?	Adelina Paqarrizi, drejtoreshë e "OJQ Hareja"	Aprovohet	Ishte nje lloje falenderimi
Pyetje rreth mundësisë si të realizohet barazia gjinore në udhëheqje institucionale?	Habibe Haxhimustafa, shefe e sektorit	Aprovohet pjeserisht	Kemi arritur përparim dhe do te vazhdojem te ecim ne drejtim te përmbushjes se barazisë gjinore

	për barazi gjinore		
--	-----------------------	--	--

4.2 KËRKESAT SI REZULTAT I DËGJIMEVE BUXHETORE TË MBAJTURA PËR PROJEKT-PROPOZIM BUXHETIN PËR VITIN 2026

INVESTIME KAPITALE			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Sa i përket rrymës jemi me Prizren. Kryetari le të bën përmirësime në lidhje me rrymë, sepse dëmet janë shumë të mëdha në biznese. Kemi probleme me reduktime të rrymës, sepse as gjeneratorët nuk janë duke punuar.	Emine Duraku (Gratë e Krushës së Madhe)	Adresohet	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar se kjo është Kompetencë e KEDS-it, andaj në bashkëpunim me shefin e Kabinetit kjo kërkesë adresohet në KEDS
- Kemi problem me rrymë në kompani, ndërprerjet e rrymës janë pa paralajmërim dhe ndikojnë direkt në dëmtim të produkteve. - Në kompani kemi probleme gjithashtu edhe me kanalizim. - Asfaltimi i rrugëve në anën e Gradishit, sepse rrugët nuk janë në nivel. - Trajtimi i rrugës afër kompanisë,	Teuta Krasniqi (Gratë në Eurofood në Xërxë)	- Kompetencë e KEDS-it - Aprovohet pjesërisht - Aprovohet pjesërisht - Aprovohet	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar se kjo është Kompetencë e KEDS-it, andaj në bashkëpunim me shefin e Kabinetit kjo kërkesë adresohet në KEDS. Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar se kjo kërkesë aprovohet pjesërisht dhe drejtoria për shërbime publike dhe ta korrigjoj sipas mundësisë aty ku ka kontratë. Grupi punues konstaton se kjo kërkesë është veçse në planet investive të Komunës.

nevoja për një rreth.			Komuna e Rahovecit ka kontratë me operatorë për ndërtimin e rrugëve lokale, andaj do ta shohim mundësinë që rrugët të nivelizohen. Grupi punues konstaton se kjo kërkesë është veçse në planet investive të Komunës.
Kyqjet në rrugë në qytet prej rrugëve dytësore, kanë mbetur shumë keq. Gjendja e kyqeve të rrugëve në qytet. Te shtëpia e Jashar Ismës dhe te varrezat e sërbëve.	Nazmi Mashuku	Aprovohet	Grupi punues konstaton se kjo kërkesë është veçse në planet investive të Komunës. Komuna e Rahovecit ka kontratë me operatorë për ndërtimin e rrugëve lokale.
Kemi nevojë për intervenim për kanalizim, sepse gjendja është mjaft delikate. Mundësisht të na ndihmoni më shumë për "rënie" të kanalizimit.	Menaxheri Eurofood në Xërxë	Aprovohet	Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën dhe në koordinim drejtorinë e shërbimeve publike ka konstatuar se Komuna e Rahovecit ka planifikuar intervenimin me kohë.
1. Pengesat në trotualet në qendër të fshatit Ratkoc 2. Rregullimi i disa parqeve për fëmijë në hapësirat publike (vendosja e disa lodrave për fëmijë)	Sahit Hoti, Ratkoc	1. Aprovohet 2. Aprovohet	Grupi Punues i Komunës së Rahovecit, pas konsultimeve me banorët e fshatit Ratkoc, vlerëson se pengesat në trotualet në qendër të fshatit paraqesin rrezik për sigurinë e këmbësorëve dhe pengojnë qarkullimin normal, andaj, në bashkëpunim me drejtorinë e Shërbimeve Publike do ta përfshijnë në kontratat eksistuese për largimin dhe përmirësimin e trotuareve, duke siguruar kështu një ambient më të sigurt dhe më funksional për banorët. Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën dhe në koordinim DKRS ka konstatuar se

			Komuna e Rahovecit do të vazhdojë të investojë në këndet e lodrave dhe parqeve.
1. Trotuari Vrajak-Ratkoc -Trotuari Vrajak – Bratotin, si dhe rregullimi i rrugës 200m prej Vrajak deri Sapniq. 2.Kërkesë për shtrimin e rrugës afër shtëpise së dëshmorit Sabri Morina	Muharrem Morina, kryetar i fshatit Vrajak	1. Pranohet pjesërisht 2. Pranohet	Grupi Punues i Komunës së Rahovecit, pas konsultimeve me banorët e fshatit Vrajak-Ratkoc dhe Bratotin, vlerëson se, në bashkëpunim me drejtorinë e Shërbimeve Publike do të shohin mundësinë që ta përfshijnë në kontratat eksistuese si dhe rregullimin e rrugës nga Vrajaka në Sopniq varësisht prej mundësive buxhetore to ta shqyrtojnë mundësinë. Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën dhe në koordinim me DSHP do ta fusin në buxhet këtë rrugë.
1. Rrethimi i oborrit te shkolles 2. Disa kanale të kullimit të ujërave atmosferik 3. Kubëzimi i disa rrugëve në fshat - ndriçimi publik prej Festivalit deri te lagja e re?	Muharrem Morina, Dejn	1. Aprovohet 2. Aprovohet 3. Aprovohet	Grupi punues në mbledhjen e mbajtur në koordinim me drejtoritë përkatëse kanë vlerësuar që këto kërkesa do të futen në buxhet.
Intervenimi në rregullimin e kanalizimit në lagjen afër fshatit Dejn	Besim Hoti, Ratkoc	Aprovohet	Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën dhe në koordinim drejtorinë e shërbimeve publike ka konstatuar se Komuna e Rahovecit ka planifikuar intervenimin me kohë për shkak që e dijmë që ky problem është sfidë.
Kanalizimi në fshatin Xërxë në lagjen Rakita	Sejfulla Thaqi, Xërxë	Aprovohet	Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën dhe në koordinim drejtorinë e shërbimeve publike ka konstatuar se Komuna e Rahovecit ka planifikuar intervenimin me kohë për shkak që e dijmë që ky problem është sfidë për Xërxën dhe për Fortesën sepse ekziston rreziku i vërshmeve.

Kanalizimi i bllokuar në fshatin Gexhë	Gazmend Kastrati, Gexhë	Aprovohet pjesërisht	Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën dhe në koordinim drejtorinë e shërbimeve publike ka konstatuar se Komuna e Rahovecit do të shoh mundësinë e intervenimit.
Shtrimi i kubëzave në një rrugë në Gexhë, ka shkaktuar në përmbytje dhe rritje të nivelit të ujit që po dëmton pronën private	Rrahim Morina, Gexhë	Aprovohet pjesërisht	Grupi punues konstaton se kjo kërkesë është veçse në planet investive të Komunës. Komuna e Rahovecit ka kontratë me operatorë për ndërtimin e rrugëve lokale. 1.
1. Pastrimi i lumit të fshatit Fortesë (Bellaja) 2. Rruga me katër korsi 3. Mungesë të mjekëve në ambulantën e fshatit 4. Asfaltimi i rrugës në kodrën e trimave 5. Rregullimi i një këndi të lojërave për fëmijë	Besnik Popaj, përfaqësues i fshatit Fortesë	1. Aprovohet pjesërisht 2. Aprovohet 3. Aprovohet pjesërisht 4. Refuzohet 5. Aprovohet	Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën dhe në koordinim drejtorinë e shërbimeve publike ka konstatuar se Komuna e Rahovecit do ta shoh mundësinë e intervenimit me kohë për shkak që e dijmë që ky problem është sfidë për Xerxën dhe për Fortesën sepse ekziston rreziku i vërshmeve Gjatë mbledhjes së radhës të Grupit Punues për Dëgjimet Buxhetore, është shqyrtuar kërkesa e paraqitur nga komuniteti dhe përfaqësuesit lokalë Si rezultat, kërkesa është miratuar unanimisht nga anëtarët e grupit punues dhe është përfshirë në listën e projekteve prioritare që do të procedohen për planifikimin e buxhetit të ardhshëm. Po ashtu, është rekomanduar që njësitë përkatëse profesionale të fillojnë fazat e para të përgatitjes së dokumentacionit teknik dhe vlerësimit të kostos. Gjatë mbledhjes së Grupit Punues për Dëgjimet Buxhetore, është shqyrtuar kërkesa e paraqitur nga banorët lidhur me mungesën e mjekëve në ambulantën e fshatit. Pas diskutimit dhe

			analizimit të resurseve ekzistuese, grupi punues ka konstatuar se problemi është i bazuar dhe se nevojiten masa për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore. Kërkesa është pranuar pjesërisht, me arsyetimin se aktualisht ekziston kufizim buxhetor dhe mungesë e kuadrit të disponueshëm 4. Gjatë mbledhjes së Grupit Punues për Dëgjimet Buxhetore është shqyrtuar kërkesa e paraqitur për asfaltimin e rrugës në Kodrën e Trimave. Pas vlerësimit të gjendjes aktuale, prioritetëve komunale dhe mundësive financiare, grupi punues ka konstatuar se projekti nuk mund të përfshihet në buxhetin e periudhës së ardhshme. Kërkesa është refuzuar, me arsyetimin se: • projekti nuk është i përfshirë në planifikimet infrastrukturore të këtij viti, • mungojnë fondet e mjaftueshme për realizimin e tij, • dhe disa projekte me urgjencë më të lartë infrastrukturore janë vlerësuar si prioritare. Megjithatë, kërkesa do të rikonsiderohet në fazat e ardhshme të planifikimit
--	--	--	---

			strategjik, varësisht nga mundësitë buxhetore dhe prioritetet zhvillimore. jatë mbledhjes së Grupit Punues për Dëgjimet Buxhetore është shqyrtuar kërkesa për rregullimin e një këndi të lojërave për fëmijë në zonën përkatëse. Pas vlerësimit të nevojave të komunitetit, rëndësisë së hapësirave rekreative për fëmijë dhe mundësive financiare, grupi punues ka vlerësuar se projekti është i realizueshëm dhe me ndikim pozitiv në mirëqenien e banorëve. Si rezultat, kërkesa është aprovuar, duke u përfshirë si projekt prioritar në planifikimin e buxhetit.
1.Rehabilitimi i rrugëve te varrezat e dëshmorëve 2.Degëzimi i kanalizimit në dy lagje	Betim Popaj, Fortesë	1. Aprovohet 2. Aprovohet	Gjatë mbledhjes së Grupit Punues për Dëgjimet Buxhetore është shqyrtuar kërkesa për rehabilitimin e rrugëve te varrezat e dëshmorëve. Pas analizimit të rëndësisë së lokacionit, gjendjes së infrastrukturës aktuale dhe ndikimit në qarkullimin e qytetarëve, grupi punues ka vlerësuar se

			projekti paraqet prioritet dhe është plotësisht i justifikuar. Kërkesa është aprovuar, duke u përfshirë në listën e projekteve të planifikuara për buxhetin e ardhshëm. Gjatë mbledhjes së Grupit Punues për Dëgjimet Buxhetore është shqyrtuar kërkesa e paraqitur nga banorët për degëzimin e kanalizimit në dy lagje, me qëllim përmirësimin e kushteve sanitare dhe funksionalitetit të rrjetit ekzistues të kanalizimit. Pas vlerësimit teknik dhe analizës së mundësive buxhetore, grupi punues ka konstatuar se projekti është i domosdoshëm dhe i realizueshëm brenda planifikimeve të ardhshme. Kërkesa është aprovuar, duke u përfshirë në listën e projekteve që do të procedohen në buxhetin e radhës.
1.Pastrimi dhe mirëmbajtja e lumit për arsye të vërshimeve që po ndodhin në kohët e fundit në fshatin Fortesë 2.Probleme me kanalizimin, të kryhet mirëmbajtja në rrugën Sahit Popaj	Kujtim Popaj, Fortesë	1. Aprovohet Pjeserisht 2. Aprovohet Pjeserisht	Gjatë mbledhjes së Grupit Punues për Dëgjimet Buxhetore është shqyrtuar kërkesa për pastrimin dhe mirëmbajtjen e lumit në fshatin Fortesë, me qëllim reduktimin e rrezikut të vërshimeve që janë paraqitur ditëve të fundit. Pas analizimit të gjendjes së terrenit, kapaciteteve aktuale dhe mundësive buxhetore, grupi punues ka vlerësuar se

			ndërhyrjet urgjente janë të domosdoshme. Kërkesa është aprovuar pjesërisht, me arsyetimin se: 1. mund të ndërmerren vetëm punime të pjesshme dhe intervenime emergjente për pastrim në segmentet më të rrezikuara të lumit, 2. ndërsa projekti i plotë i mirëmbajtjes afatgjatë do të shqyrtohet në fazat e ardhshme të planifikimit buxhetor, për shkak të kufizimeve financiare dhe teknike. 2. Grupi Punues ka shqyrtuar kërkesën lidhur me problemet e paraqitura në sistemin e kanalizimit dhe nevojën për kryerjen e mirëmbajtjes në rrugën “Sahit Popaj”. Pas analizimit të gjendjes aktuale, kapaciteteve teknike dhe mundësive financiare brenda buxhetit të planifikueshëm për periudhën vijuese, konstatohet se intervenimi është i nevojshëm, por jo
--	--	--	---

			tërësisht i realizueshëm në këtë fazë. Për këto arsye, Grupi Punues vendos që kërkesa të pranohet pjesërisht, duke përfshirë në planifikim vetëm punimet emergjente dhe ato që ndikojnë drejtpërdrejt në shmangien e dëmtimeve të mëtejshme. Pjesa tjetër e intervenimeve do të shqyrtohet në fazën e rishikimit buxhetor ose në ciklin e ardhshëm të planifikimit, në varësi të mjeteve të disponueshme.
1.Kubëzim të rrugëve. 2.Rrugë fushore, 3.Rrjeti elektrik të rristrukturohet 4.Kanalizime	Skender Krasniqi - Opterushë	1. Aprovohet 2. Aprovohet 3. Adresohet 4. Aprovohet	Grupi Punues ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur për kubëzimin e rrugëve si dhe rregullimin e rrugës fushore në fshatin Opterushë. Pas vlerësimit të nevojave infrastrukturore, qarkullueshmërisë së banorëve dhe ndikimit në përmirësimin e kushteve të jetesës në këtë zonë, është konstatuar se intervenimet e propozuara janë të justifikuara dhe të realizueshme brenda kuadrit të planifikimit buxhetor. Duke marrë parasysh prioritetet e komunitetit, rëndësinë e aksesit për banorët dhe mundësitë financiare të parapara për investime kapitale, Grupi Punues vendos që kërkesa të aprovohet dhe të përfshihet në planifikimin e

			projekteve për periudhën përkatëse. Kërkesa e trete është kompetencë e KEDS-it. Grupi Punues ka shqyrtuar kërkesën për kryerjen e kanalizimeve në fshatin Opterushë. Pas vlerësimit të gjendjes ekzistuese të infrastrukturës dhe nevojave të komunitetit, është konstatuar se ndërhyrja është e nevojshme dhe e realizueshme brenda kuadrit të planifikimit buxhetor. Për këto arsye, kërkesa aprovohet dhe do të përfshihet në planifikimin e projekteve për periudhën e ardhshme.
1. Rrugicat e mbetura të përfundojnë. 2. Vazhdimi i lumit, të shtrohet lumi dhe të vazhdohet deri te Ura e Ritijës. 3. Shteg për ecje nga fshati Retijë.	Enver Kabashi - Zoqisht	1. Aprovohet 2. Aprovohet 3. Aprovohet	Grupi Punues ka shqyrtuar kërkesat e paraqitura nga banorët e fshatit Zoqisht dhe pas vlerësimit të gjendjes ekzistuese të infrastrukturës dhe nevojave të komunitetit, vendos: 1. Përfundimi i rrugicave të mbetura – aprovohet për përmirësimin e qarkullueshmërisë dhe aksesit të banorëve. 2. Vazhdimi dhe shtroja e lumit deri te Ura e Ritijës – aprovohet për

			sigurimin e kullimit adekuat dhe qarkullimin e sigurt në zonë. 3. Shteg për ecje nga fshati Retijë – aprovohet për promovimin e mobilitetit dhe aktiviteteve rekreative. Për këto arsye, të gjitha kërkesat e paraqitura nga fshati Zoqisht aprovohen dhe do të përfshihen në planifikimin buxhetor për realizim në periudhën e ardhshme.
1.Meremetimi i shkollës 2.Trotuaret e fshatit janë kërkesë tjetër dhe vazhdimi i kubëzimit të rrugëve të mbetura. 3.Kanalizimi, sepse ende kemi gropa septike. 4.Ngjyrosja e murit të varrezave të fshatit. 5.Zgjerimi i ndriqimit nëpër lagje. 6.Mirëmbajtja e hapësirave publike.	Mirsad Qehaj - Retijë e Poshtme	1. Aprovohet 2. Aprovohet 3. Aprovohet 4. Refuzohet 5. Aprovohet 6. Aprovohet	Grupi Punues ka shqyrtuar kërkesat e paraqitura nga banorët e fshatit Retije e Ulët dhe, pas vlerësimit të gjendjes së infrastrukturës dhe nevojave të komunitetit, vendos: 1. Meremetimi i shkollës – aprovohet për përmirësimin e kushteve të mësimi dhe sigurimin e ambientit të sigurt për nxënësit. 2. Trotuaret e fshatit dhe vazhdimi i kubëzimit të rrugëve të mbetura – aprovohet për përmirësimin e qarkullueshmërisë dhe aksesit nëpër fshat.

